



Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

# DREJT DITËS SË ZGJEDHJEVE:

Përgatitjet parazgjedhore, dinamikat  
dhe trendet e parafushatës

Demokracia në Veprim

Zgjedhjet parlamentare 2025





# PËRMBAJTJA

## 1. Hyrje

## 2. Puna e trupave menaxhuese zgjedhore

- 2.1. Administrimi i procesit zgjedhor nga KQZ-ja në 90 ditë
- 2.2. Informimi dhe Edukimi i Votuesve
- 2.3. Votimi Jashtë Vendit

## 3. Parafushata e subjekteve politike

- 3.1. Qasja e subjekteve politike në parafushatë dhe zhvillim të platformave politike
- 3.2. Listat e kandidatëve të subjekteve politike
- 3.3. Trendet e parafushatës në platforma dixhitale
- 3.4. Toni dhe gjuha e parafushatës

## 4. Sa po e cenon qeveria integritetin zgjedhor?

- 4.1. “Përzierja” e ekzekutivit në votimin jashtë vendit
- 4.2. A mund t’a ndikojnë vendimet e Qeverisë rezultatin zgjedhor?
- 4.3. Shfrytëzimi i resurseve publike për qëllime elektorale

Copyright ©2024. Demokracia në Veprim (DnV).

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

**Demokracia në Veprim**

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 239  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 248 038  
[www.demokracianeveprim.org](http://www.demokracianeveprim.org)



# 1. HYRJE

Pas shpalljes së zgjedhjeve parlamentare nga Presidentja e Kosovës më 16 gusht 2024, KQZ-ja ka filluar me procedurat dhe operacionet zgjedhore, periudhë kjo e intensifikuar e përgatitjeve për ditën e zgjedhjeve – që është rreth 90 ditë larg.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka ndërmarrë hapat e paraparë ligjor në organizimin e procesit zgjedhor, duke miratuar një kuadër operacional relativisht gjithëpërfshirës për të siguruar që të gjitha proceset përgatitore zhvillohen sipas afateve dhe përcaktimeve tjera ligjore. Po ashtu, legjislacioni sekondar, e nevojshme për këto zgjedhje, ishte përmbyllur nga KQZ-ja pak kohë para shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe fillimit të aktiviteteve operationale zgjedhore.

Në përputhje me planet operationale, gjatë tre muajve të fundit, KQZ ka realizuar disa aktivitete thelbësore për procesin zgjedhor. Ato përfshijnë shqyrtimin e koalicioneve të deklaruara, hapjen e periudhës për ndryshimin e qendrës së votimit, miratimin e listave të qendrave të votimit si dhe fillimin e procedurës së regjistrimit të votuesve jashtë vendit. Për më tepër, KQZ ka nisur një fushatë informuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin zgjedhor, paralelisht me ndryshimet e fundit substanciale në legjislacionin zgjedhor – përfshirë dyfishimin e votës preferenciale deri në 10 kandidatë, mënyrat e reja për votimin jashtë vendit, numërimin e rezultateve të kandidatëve, e të tjera. Këto hapa kanë kontribuar në një qasje më sistematike për të ofruar transparencë për votuesit.

Në anën tjetër, partitë politike kanë treguar një angazhim më të ngadaltë në procesin formal të certifikimit të tyre dhe kandidatëve me të cilët garojnë. Praktikrat e kaluara tregojnë se dorëzimi i aplikacioneve ndodhë shumë afër përfundimit të afateve ligjore, që në rastin e këtyre zgjedhjeve është mes i muajit dhjetor. Megjithatë, gjashtë koalicione, që përfaqësojnë dymbëdhjetë parti politike, janë regjistruar tashmë pranë KQZ-së, duke treguar angazhimin për ndërtimin e koalicioneve parazgjedhore si një prioritet strategjik. Për më tepër, janë evidente edhe rastet e shpërfaqjes së emrave të kandidatëve. Edhe pse nuk janë certifikuar formalisht për të garuar në këto zgjedhje, ato tashmë kanë filluar organizimin e aktiviteteve për të rritur numrin e përkrahësve/votuesve brenda vendit dhe në diasporë, duke dhënë indicie për një parafushatë mjaft intensive.

Këto zhvillime të hershme kanë mobilizuar edhe rrjetin e organizatave të shoqërisë civile “Demokracia në Veprim” (DnV) për të filluar përgatitjet për vëzhgimin e procesit zgjedhor. Fushata zgjedhore 30 ditëshe do të monitorohet nga 38 vëzhgues afatgjatë në të gjitha komunat e Kosovës, ndërsa gjatë Ditës së Zgjedhjeve, 550 vëzhgues të tjerë afatshkurtër do të angazhohen për të mbikëqyrur procesin sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave, e njohur si PVT. Angazhimi i DnV-së do të përfshijë gjithashtu monitorimin e shpenzimeve të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për kryemnistër në platformat e rrjeteve sociale, duke qenë se fushatat dixhitale tashmë kanë filluar të zënë një vend shumë të rëndësishëm në garën zgjedhore po bëhen mjeti i pazëvendësueshëm i komunikimit dhe tërheqjes së masës së votuesve.



## 2. PUNA E TRUPAVE MENAXHUESE ZGJEDHORE



### 2.1. Administrimi i procesit zgjedhor nga KQZ-ja në 90 ditë

Që nga shpallja e ditës së zgjedhjeve parlamentare nga Presidentja, KQZ-ja ka zhvilluar rreth 20 mbledhje në të cilat janë diskutuar dhe miratuar shumë vendime, përfshirë planin operacional. Shumica e vendimeve janë arritur në mënyrë konsensuale dhe në një atmosferë pozitive, me përjashtim të rastit kur ishte trajtuar numri i qendrave të votimit për votimin jashtë vendit, që nxiti përplasje politike midis anëtarëve nga partia në pushtet dhe anëtarëve të tjerë.

Meqë zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit do të jenë të parat të rregullta që nga shpallja e pavarësisë, operacionet e KQZ-së nuk do të implementohen sipas afateve të shkurtuara. Por, ndonëse me më shumë kohë në dispozicion, KQZ-ja ka shënuar vonesa në miratimin e përbërjes së komisioneve komunale zgjedhore, qendrave komunale të numërimit dhe publikimit të qendrave të votimit jashtë vendit, duke tejkaluar afatet e planit operacional e madje edhe përcaktimet ligjore përkatëse. Nxjerrja e vonshme e vendimit të KQZ-së për qendrat e votimit jashtë vendit, është rezultat i mosfrimit me kohë të informatave mbi misionet diplomatike të Kosovës nga Ministrisa e Punëve të Jashtme.

Sa i përket trupave menaxhuese zgjedhore të nivelit lokal, për shkak të bojkotit dhe dorëheqjeve nga përfaqësuesit serbë lokalë në komunat veriore, KQZ-ja u detyrua të caktojë persona nga komuna të tjera, si ushtrues detyre të zyrtarëve komunal zgjedhor të këtyre komunave – një vendim që bie ndesh me ligjin, por që shërbeu përkohësisht për të mbuluar këtë mungesën e stafit nga ato komuna.



KQZ-ja ka bërë progres të rëndësishëm duke digjitalizuar pjesën më të madhe të operacioneve zgjedhore, nëpërmjet një softueri të zhvilluar me ndihmën e OSBE-së. Tanimë, votuesit do të mund të gjejnë apo ndryshojnë qendrën e tyre të votimit online, do të mund të aplikojnë për regjistrim për votim jashtë vendit apo mund të regjistrohen si votues me nevoja të veçanta. Në anën tjetër edhe subjektet politike do të mund të kryejnë procesin e regjistrimit dhe certifikimit për veten dhe për kandidatët e tyre online, ndërsa vëzhguesit do të mund të aplikojnë për akreditim. Kjo platformë online përveç që i kontribuon lehtësimit të proceseve dhe qasje së palëve në shërbime të caktuara zgjedhore, do të mundësojë edhe publikimin e rezultateve preliminare në kohë të shpejtë."

Gjithashtu, në fund të gushtit, KQZ-ja organizoi një simulim të procesit të votimit dhe numërimit, ku ishin të përfshirë të gjithë akterët relevantë. Ky simulim kontribuoi në identifikimin dhe adresimin e problemeve potenciale brenda procesit, duke reflektuar përkushtimin për një organizim efikas dhe gjithëpërfshirës të zgjedhjeve.



Vlen të theksohet që risi të këtij procesi pritet të jenë **vendosja e kamerave nëpër secilin vendvotim, si dhe matrikulimi i gishtërinjve të votuesve** – që ka zëvendësuar aplikimin e dritës ultravjollcë. Derisa për kamerat, esenciale mbetet vetëm që vendosja e tyre të mos jetë e atillë që mund të cenojë fshehtësinë e votës, matrikulimi është më problematik. Edhe pse ky vendim ishte marrë para shpalljes së zgjedhjeve, i njëjti nuk ishte arsyetuar. Për më tepër, për këtë çështje ka pasur edhe përfshirje të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, e cila i kishte vlerësuar që matrikulimi si formë e shënimit të votuesve cenon fshehtësinë e votës dhe lirinë e zgjedhjes – duke i rekomanduar KQZ-së gjetjen e formave alternative për garantimin e integritetit zgjedhor. Megjithatë, përkundër një këshille të tillë, KQZ-ja ende nuk ka marrë asnjë veprim në këtë drejtim.



## 2.2. Informimi dhe Edukimi i Votuesve

Në funksion të informimit sa më të hershëm të votuesve, KQZ-ja për herë të parë dhe në mënyrë më proaktive u përfshi në përgatitjen dhe publikimin e disa videove të shkurta informuese, përmes së cilave është synuar që të informohen votuesit mbi ndryshimet në procedurat e votimit të cilat ishin motivuar nga ndryshimet e fundit në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Me anë të këtyre videove informuese, të cilat janë shfaqur sidomos gjatë muajit gusht në RTK dhe në rrjetet sociale të KQZ-së janë paralajmëruar ndryshimet sa i përket votimit preferencial nga 5 në 10 kandidatë dhe mënyrat e reja të votimit për votuesit jashtë vendit. Në dy javët e fundit, në platformën e KQZ-së në Facebook janë publikuar edhe “infografika” dhe “animacione” që në përmbajtje janë informative - kryesisht për mënyrat e votimit. Këto produkte janë publikuar në të dy gjuhët zyrtare, dhe disa prej tyre edhe në gjuhën e shenjave. Nga monitorimi i këtyre postimeve shihet që nuk është duke u bërë përpjekje e mjaftueshme për të arritur tek grupet e synuara pasi interaksioni me publikun (pëlqimet, angazhimet) është minimal, përkundër që faqja e KQZ-së ka mbi 48 mijë ndjekës.

Një mangësi e rëndësishme është se fushatat informuese të KQZ-së nuk kanë targetuar drejtpërdrejt votuesit jashtë vendit. Duke qenë se këto fushata mbështeten kryesisht në profilin në Facebook apo ueb faqen e KQZ-së, ato kanë një ndikim të kufizuar tek diaspora. Përveç kësaj, strategjia formale për informimin publik nga KQZ-ja nuk është ende e konsoliduar, dhe nuk ka pasur vlerësim të efektivitetit të strategjive të mëparshme – që zakonisht kanë qenë identike. Edhe pse KQZ-ja ka në dispozicion fonde të mëdha për këto fushata, ato zakonisht nuk janë të targetuara mirë dhe nuk përdorin metoda inovative, duke qenë shpesh të kontraktuara tek kompani private. Aktualisht, KQZ-ja ka planifikuar të angazhojë ekspert të jashtëm për të ndihmuar në hartimin e strategjisë së informimit publik.

Ndërkohë, në nivel komunal, janë organizuar sesione informuese për qytetarët rreth procesit zgjedhor, veçanërisht për ndryshimet e votës preferenciale dhe votimin jashtë vendit. Këto aktivitete në terren përmirësojnë ndërgjegjësimin, veçanërisht në zonat që kanë nevojë për qartësi shtesë.




## 2.3. Votimi Jashtë Vendit

Votimi jashtë vendit përbën një ndër operacionet zgjedhore me ndryshimet më domethënëse, pas ndryshimeve të fundit në legjislacionin zgjedhor të Kosovës.

Tani qytetarët që jetojnë në diasporë kanë në dispozicion edhe dy mënyra të reja për votim jashtë vendit, përveç votimit përmes postës në Kosovë: mundësinë që të votojnë fizikisht në misionet diplomatike të Kosovës jashtë vendit, ose përmes kutive postare të hapura nga KQZ-ja në misionet diplomatike të Kosovës, jashtë vendit. KQZ-ja ka përcaktuar tashmë 22 shtete, në të cilat do të hapen gjithsej 35 qendra votimi me 47 vendvotime, me numër maksimal prej 1,000 votuesish në secilën prej tyre.

Deri më tani, ka pasur rreth 15 mijë aplikime për votim jashtë vendit, nga të cilat rreth 13 mijë janë miratuar. Pothuajse dy të tretat e aplikimeve të aprovuara janë për votim me postë në misionet diplomatike, ndërsa rreth 4 mijë – ose 30% e aplikimeve të miratuara – janë për votim fizik në misionet diplomatike.

Shumica e aplikimeve të miratuara janë nga vende si Gjermania, Zvicra, Italia, Franca dhe Suedia. Edhe në këto vende, aplikimet për votim fizik përbëjnë vetëm një të tretën e aplikimeve totale. Javët e fundit, është vërejtur një rritje e trendit të aplikimeve, që përkon me intensifikimin e aktiviteteve të partive politike jashtë vendit.







## 3. PARAFUSHATA E SUBJEKTEVE POLITIKE



### 3.1. Qasja e subjekteve politike në parafushatë dhe zhvillim të platformave politike

Për shkak të mungesës së rregullimit ligjor të parafushatës zgjedhore, partitë politike në Kosovë kanë zhvilluar aktivitetet e tyre të hershme të parafushatës pa kufizime të përcaktuara mbi kohën apo përm-bajtjen. Ky vakum mundëson një fleksibilitet të partive në taktikat e tyre. Në ndërkohë, pjesëmarrja e eksponentëve të ndryshëm politik, sidomos atyre nga spektri opozitar në debatet kryesore televizive, është shndërruar në trend mjaft të shprehur.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përcaktuar një kufi shpenzimesh për partitë në periudhën e fushatës zyrtare zgjedhore, duke e vendosur në 1 euro për votues— me një total prej rreth 2 milion euro si tavan i shpenzimeve maksimale për këto zgjedhje parlamentare. Shuma prej 1 euro, përbën një dyfishim të shpenzimit minimal për votues, nga 0.50 EUR për votues sa ishte në zgjedhjet e fundit. Ndonëse kufizimi vlen vetëm për periudhën e fushatës zyrtare 30 ditore, subjektet politike do të duhet të raportojnë për të gjitha shpenzimet e kryera 90 ditë para ditës së zgjedhjeve, e deri në ditën e zgjedhjeve.

Partitë kanë përdorur qasje të ndryshme për t'iu qasur votuesve. Partia në pushtet, **Lëvizja Vetëvendosje**, e udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti, **ka zhvilluar parafushatë përmes së cilës ka theksuar arritjet e qeverisë, duke promovuar vendimet qeveritare për të dëshmuar udhëheqjen e saj. Lëvizja Vetëvendosje** është i vetmi subjekt politik që nuk ka organizuar ende asnjë takim publik me qytetarë në Kosovë. Në vend të kësaj, duket se ajo e ka orientuar parafushatën e saj jashtë vendit, me Kryeministrin Kurti dhe ministra të tjerë që kanë marrë pjesë vazhdimisht në takime me diasporën nëpër Evropë dhe më tej, duke shfrytëzuar bazën e tyre të krijuar në diasporë.

Në anën tjetër, partitë opozitare kanë zbatuar metoda të tjera të përfshirjes dhe angazhimit të votuesve. Shumica e partive opozitare, veçse kanë filluar takimet pothuajse të përditshme me qytetarë në Kosovë, por edhe jashtë vendit.

**Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka adoptuar një model konsultativ lidhur me hartimin e programit politik, duke organizuar punëtori në të gjithë vendin për të ndërtuar platformën e saj politike bazuar në kontributin e publikut.** Kjo qasje ka synuar të krijojë një ndjenjë përfshirjeje dhe përgjegjshmërie.

Ndërsa **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka përdorur një strategji nga poshtë-lart, duke organizuar takime derë më derë me qytetarët për të krijuar lidhje të drejtpërdrejta dhe për të promovuar programin e saj politik** – i cili fillimisht ishte shpalosur përmes një konvente nacionale 11 muaj më parë. Një qasje e ngjashme e takimeve të targetuara është ndjekur edhe nga koalicioni **AAK-NISMA**.





Partia në pushtet - LVV, ende nuk ka publikuar një program politik.



### 3.2. Listat e kandidatëve të subjekteve politike

Afati për dorëzimin e aplikimeve për certifikim dhe listave të kandidatëve nga partitë politike është caktuar për datën 12 dhjetor. Deri në këtë periudhë, shumica e partive kanë përfunduar procesin e hartimit të listave ose janë në fazën përfundimtare të këtij procesi. Përtej aspektit të integritetit të kandidatëve, vëmendja mbetet te mënyra se si partitë po përzgjedhin dhe publikojnë kandidatët e tyre për zgjedhjet e ardhshme, si dhe te strategjitë që po përdorin për të maksimalizuar mbështetjen elektorale.

Ndërsa partitë opozitare, veçanërisht Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë nisur publikimin e kandidatëve për çdo komunë – të nominuar nga degët përkatëse të partive – Partia Demokratike e Kosovës ka filluar gjithashtu të publikojë disa nga kandidatët kryesorë në nivel qendror. Në kontrast, partia në pushtet, Vetëvendosje, ende nuk e ka hapur këtë proces për publikun dhe deri më tani nuk ka ndarë informacione rreth vendimeve apo diskutimeve të saja.

Një veçori tjetër e dallueshme e këtij procesi është **kandidatura e disa kryetarëve aktualë të komunave për pozitat e deputetëve**, veçanërisht brenda radhëve të LDK-së, por edhe në partitë të tjera. Kjo duket të jetë një përpjekje për të mobilizuar votuesit në rajone ku figurat e kryetarëve gëzojnë popullaritet dhe mbështetje të konsiderueshme. Kandidimi i kryetarëve si deputetë paraqet jo vetëm një strategji për të rritur bazën elektorale, por gjithashtu një lloj testimi për të matur mbështetjen e tyre popullore në prag të zgjedhjeve lokale, të cilat do të mbahen në fund të vitit të ardhshëm.

Sa i përket përbërjes së listave, ajo që vihet re është një prirje drejt **përfshirjes së gjeneratave të reja dhe grave, në radhët e kandidatëve**. Në listat që janë bërë publike, shumica e kandidatëve përfaqësojnë një brez të ri politikanësh, me një moshë mesatare më të re sesa më parë. Kjo përbërje më e re e kandidatëve reflekton një përpjekje të partive për të rinovuar imazhin e tyre dhe për të përmbushur kërkesat e elektoratit për përfaqësim më të freskët dhe energjik. Megjithatë, në listat janë të pranishëm edhe kandidatë që kanë mbajtur pozita në legjislativ ose ekzekutiv më parë.

Në tërësi, procesi i hartimit dhe publikimit të listave të kandidatëve paraqet një aspekt të rëndësishëm për zgjedhjet e ardhshme dhe ofron një mundësi për të vlerësuar strategjitë elektorale të partive politike. Qasja e ndryshme në publikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve dhe përfshirja e figurave lokale të respektuara tregojnë përpjekjet e partive për të maksimizuar mbështetjen, ndërkohë që përbërja e listave me kandidatët më të rinj mund të ndikojë pozitivisht te perceptimi publik për partitë si forca që përfaqësojnë zhvillim dhe rinovim politik.





### 3.3. Trendet e parafushatës në platforma dixhitale

Duke iu afruar zgjedhjeve, aktiviteti politik në platformat digjitale, veçanërisht në Facebook dhe Instagram (Meta), është intensifikuar. Partitë po përdorin këto platforma për të arritur tek një audiencë më e gjerë e votuesve, duke postuar disa herë në ditë, shpesh me sponsorizime të paguara për të rritur shtrirjen. Lëvizja Vetëvendosje, si parti në pushtet nuk ka një evidencë të sponsorizimeve, ndërsa partitë opozitare janë shumë aktive.

**Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** ka shpenzuar rreth **7 mijë euro** në rreth **10 postime** të sponsorizuara në Facebook dhe Instagram, që nga shpallja e zgjedhjeve.

**Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** ka sponsorizuar rreth **12 postime** që kapin vlerën prej më pak se **1 mijë euro** derisa kandidati i saj për kryeministër ka sponsorizuar rreth **20 postime** shtesë me vlerë rreth **2,000 EUR.**

Ndërkohë, koalicioni **AAK-NISMA** kryeson në sponsorizimet në platformat dixhitale, me mbi **100 postime** nga kandidati i saj – të cilat mesatarisht kapin vlera prej mijëra euro.

Shumica dërrmuese e sponsorizimeve nga **PDK**, respektivisht kandidati i saj për kryeministër, si dhe **AAK**, respektivisht kryetari i saj, janë bërë në vlera prej më pak se **100 euro**, për të cilat Meta nuk ofron të dhëna të detajuara financiare.

Këto trende reflektojnë një varësi të shtuar nga rrjetet sociale për të përhapur mesazhe politike, por transparenca lidhur me shpenzimet dhe sponsorizimet mbetet e nevojshme për të ruajtur integritetin e zgjedhjeve.





### 3.4. Toni dhe gjuha e parafushtës

Komunikimi politik, që nga shpallja e zgjedhjeve, ka qenë përgjithësisht deri diku i moderuar. Toni i komunikimit ndërmjet partive politike, liderëve dhe kandidatëve të tyre ka qenë përgjithësisht i kontrolluar. Retorika e ashpër politike dhe përplasjet e drejtpërdrejta politike janë shmangur, ndonëse disa shembuj tregojnë polarizimin e fortë të qëndrimeve politike mes pozitës dhe opozitës.

Partitë opozitare kanë shfrytëzuar këtë periudhë kryesisht për të theksuar dështimet e qeverisë aktuale dhe për të kritikuar mungesën e realizimit të premtimeve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Kryeministrit Albin Kurti. Qasja e opozitës është orientuar në ndërtimin e një narrative kritike që përfshin përplasjet e ekzekutivit kosovar me aleatët kryesor perëndimor, sidomos SHBA-të, vendet e BE-së, që kulmuan me futjen e vendit nën sanksione nga BE-ja; vendimet e vonuara dhe dështimin për të përmbushur prioritetet e premtuara në sektorë kyç, si drejtësia, punësimi dhe infrastruktura.

Në këtë kontekst, kandidatët opozitarë kanë përshtatur një qasje komunikuese konstruktive, ku përveç kritikave, kanë orientuar parafushtat dhe diskursin publik drejt prezantimit dhe promovimit të vizioneve të tyre politike. Vlen të përmendet që një pjesë e premtimeve dhe temave të proklamuar nga partitë opozitare ishin shpesh reaktive, ndaj vendimeve të marra nga qeveria – përfshirë rastin e ngritjes së pagave.

Megjithatë, në disa raste, retorika është intensifikuar. Ramush Haradinaj, kandidati për kryeministër nga koalicioni AAK-NISMA, ka shfaqur qëndrime dhe akuza të ashpra kundrejt kryeministrit Kurti, duke përdorur gjuhë më agresive.

Nga ana tjetër, Vetëvendosje ka mbajtur një ton dhe diskurs tashmë të etabluar, duke u mbështetur në narrativen e saj kritike ndaj qeverisjeve të mëparshme, të cilat i akuzon për "shkatërrimin" e vendit dhe për korrupsion. Ky narrativ është përsëritur si pjesë e një strategjie që synon ta mbajë Lëvizjen Vetëvendosje të pozicionuar si të vetmen forcë politike reformatore, që synon të adresojë gabimet e së kaluarës dhe të vazhdojë "pastrimin" e skenës politike. Në këtë mënyrë, partia në pushtet përpiqet të ruajë mbështetjen e elektoratit të saj bazë dhe të forcojë legjitimitetin e qeverisjes aktuale.

Në skenën politike tashmë është futur edhe "Lista për Familjen", një koalicion i partive, dhe individëve (deputetë të legjislaturës së tanishme) të cilët përfaqësojnë vlera më konservatore, posaçërisht mbi rolin e familjes në shoqëri.





# 4. SA PO E CENON QEVERIA INTEGRITETIN ZGJEDHOR?

Që nga shpallja e zgjedhjeve dhe fillimi i zbatimit të operacioneve zgjedhore, janë vërejtur elemente të cilat tregojnë për përpjekje të qarta të Qeverisë për të ndikuar drejtpërdrejtë në vendimmarjen që lidhet me operacionet e caktuara zgjedhore.



## 4.1. “Përzierja” e ekzekutivit në votimin jashtë vendit

Përkundër statistikave që tregojnë se votimi përmes postës mbetet aktualisht formati më i preferuar i aplikuesve për t'u regjistruar si votues jashtë vendit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka shfaqur tendencë për ndërhyrje në procesin zgjedhor. Së fundi, kishin qarkulluar lajme se MPJD-ja u ka dërguar letër disa drejtuesve të misioneve diplomatike të Kosovës, për të kërkuar gjetjen e hapësirave alternative që do të shfrytëzoheshin si qendrave të votimit. Një kërkesë e tillë është e paligjshme, meqë KQZ-ja është i vetmi institucion me autoritet kushtetues dhe ligjor për të caktuar qendrat e votimit jashtë vendit, proces në të cilin roli i MPJD-së është lehtësues. Për më tepër, kjo letër, përbën tejkalim të kompetencave të ekzekutivit, duke e cenuar integritetin zgjedhor.

Shtimi i mundësive të votimit jashtë vendit - fizikisht në misionet diplomatike të Kosovës - ka qenë një ndër idetë dhe premtimet kryesore të partisë në pushtet, që ishte materializuar përmes ndryshimeve në legjislacionin zgjedhor gjatë vitit 2023. Tanimë, përtej ofrimit të kësaj mundësie, janë evidente përpjekjet për maksimizimin e votës së diasporës, madje "në kurriz" të kapaciteteve të munguara të KQZ-së.

Për më tepër, tejet e diskutueshme është edhe iniciativa për nënshkrimin e një Memorandumi mes KQZ-së dhe MPJD-së, lidhur me bashkëpunimin mes këtyre institucioneve lidhur me operacionin e votimit jashtë vendit. Ndonëse memorandumi nuk ka karakter obligativ, vet nënshkrimi i tij, për përcaktimin e përgjegjësive të palëve – ndonëse përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore janë qartazi të përcaktuara me ligj dhe Kushtetutë – mbetet problematik.

Për më tepër, i njëjti përmban disa paqartësi sa i përket “sigurimit të hapësirave të përshtatshme për zhvillimin e procesit zgjedhor”, proces ky i cili veçse është përmbyllur me miratimin e listës përfundimtare të qendrave të votimit jashtë vendit.







## 4.2. A mund t'a ndikojnë vendimet e Qeverisë rezultatin zgjedhor?

Periodha parazgjedhore është shoqëruar gjithashtu me një rritje të masave financiare të ndërmarra nga qeveria, të cilat kanë implikime dhe ndikime të drejtpërdrejta në procesin zgjedhor. Të njëjtat kanë kapital politik dhe perceptim të ndikimit në vullnetin e votuesve përmes vendimeve me karakter elektoral.

**Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë disa vendime me ndikim social të konsiderueshëm, siç është rritja prej 20% e pensioneve për kategori të ndryshme (e cila hyri në fuqi në tetor), rritja e pensioneve për kategoritë e luftës (e cila është planifikuar të hyjë në fuqi nga muaji janar), si dhe rritja e pagës minimale nga 264 në 350 euro. Ditëve të fundit është marrë vendimi për rritjen e pagave në sektorin publik. Kështu, pagat për shërbyesit publikë janë planifikuar të rriten me nga 55 euro nga janari i vitit 2025 e pasuar nga një rritje të dytë prej 55 eurosh nga korriku i vitit të ardhshëm.**

Masat financiare, që pritet të hyjnë në fuqi pak kohë para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit 2025 shpërfaqin një model të rrezikshëm të përpjekjes për të ndikuar votuesit nëpërmjet fondeve publike. Pra, koha dhe mënyra e marrjes së vendimeve të tilla, jo vetëm që dëmtojnë integritetin e procesit zgjedhor, por vënë në dilemë edhe përkushtimin e qeverisë ndaj parimit demokratik të garës së barabartë zgjedhore.

Me shpalljen e datës së zgjedhjeve, qeveritë duhet të përmbahen nga vendime që japin përfitime materiale ose simbolike për grupe të votuesve. Që të sigurohet një proces zgjedhor fer dhe i pandikuar, Qeveria dhe posaçërisht kryeministri Kurti, duhet të përmbahen nga ndëmarraja e masave të ë tilla financiare që mund të ndikojnë në përcaktimin e lirë të votuesve, deri në përmbylljen e procesit zgjedhor.

Në shoqëri demokratike, incentivat financiare dhe reformat në sektorin publik duhet të kenë bazë të qartë ligjore për të garantuar siguri juridike dhe stabilitet afatgjatë, duke shmangur premtimet ad-hoc që shërbejnë për interesa të ngushta politike.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme kërkojnë që asnjë zyrtar apo institucion publik të mos manipulojë politikën publike, veçanërisht ato financiare, për të fituar mbështetje politike. Qytetarët e Kosovës meritojnë një proces zgjedhor të drejtë e transparent, të bazuar në konkurrencë të barabartë politike dhe jo në premtime të financuara nga buxheti publik.



## 4.3. Shfrytëzimi i resurseve publike për qëllime elektorale

Trendet aktuale tregojnë një prirje në rritje për të vënë burimet shtetërore në funksion të aktiviteteve dhe qëllimeve elektorale.

Disa nga rastet që ilustrojnë një tendencë të tillë, përfshijnë vizitat e fundit jashtë vendit të Kryeministrit dhe ministrave, të cilat po shërbejnë më shumë si platformë për qëllime elektorale nën maskën e angazhimit diplomatik dhe diskutimeve me diasporën.

Për më tepër, së fundi, disa misione diplomatike të Kosovës, përfshirë ambasadat e Kosovës në Austri, Norvegji e të tjera, kanë publikuar një ftesë për pjesëmarrje të diasporës në atë shtet, me kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e jashtme Donika Gërvalla. Mbajtja e tubimeve politike jashtë vendit në emër të detyrës zyrtare përbën një keqpërdorim i burimeve të paguara nga taksapaguesit.

Së dyti, me fillimin e aktiviteteve të parafushatës, pritet të intensifikohen rastet e përdorimit të automjeteve zyrtare, si nga ekzekutivi qendror, ashtu edhe ata në nivel lokal – për qëllime të fushatës dhe specifikisht tubimeve elektorale. Për më keq, gjatë këtij mandati, ka pasur vendime për pajisje me targa private për veturat zyrtare të një varg institucionesh. Pamundësimi i identifikimit të automjeteve zyrtare, i justifikuar me “arsye sigurie,” minon transparencën dhe llogaridhënien. Kjo qasje, efektivisht i heq mundësinë publikut dhe organizatave të shoqërisë civile për të vërtetuar nëse këto automjete përdoren vetëm për detyra zyrtare apo për aktivitete të fushatës, duke krijuar një mungesë të rrezikshme transparence rreth shpenzimeve qeveritare.

Parimet demokratike të zgjedhjeve të lira dhe fer parashohin vija të qarta ndarëse për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve publike nga qeveritë për të ndikuar votuesit. Mjegullimi i këtyre vijave ndarëse, e dobëson parimin e barazisë mes pjesëmarrësve zgjedhorë, duke favorizuar ata që janë tashmë në pushtet dhe duke cenuar besimin e publikut në garën e ndershme elektorale. Burimet publike, përfshirë automjetet qeveritare, stafin dhe platformat diplomatike, ekzistojnë për të shërbyer interesin publik dhe jo për të promovuar agjendat partiake.





Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action